



Prishtinë, 27 nëntor 2019
Kodi i ZRRE-së: V_1193_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e nenit 26 paragrafi 1, nenit 47 dhe nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Dispozitat e nenit 19 të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e nenit 18 dhe nenit 19 të Ligjit për Energjinë Termike Nr. 05/L-052;
- Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike; dhe
- Shkresën e Ndërmarrjes Publike – Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Gjakova sh.a. të datës 14 tetor 2019.

Pas shqyrtimit të shkresës dhe bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, në seancën e mbajtur me datë 27 nëntor 2019, nxori këtë:

VENDIM

- I. APROVOHEN** tarifat e energjisë termike për konsumatorët fundorë të Ngrohtores së Qytetit (NQ) Gjakova sh.a. për sezonin e ngrohjes 2019/2020, siç janë paraqitur në tabelën 'II.1', që do të zbatohen nga data e nxerrjes së këtij vendimi.

Arsyetim

1. Me datë 14 tetor 2019, Zyra e Rregullatorit për energji (ZRRE) ka pranuar shkresën nga Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Gjakova sh.a., me anë të secilës ZRRE njohtohet për arsyet që pamundësojnë një aplikim të kompletuar dhe të bazuar në parashikime reale, për shqyrtimin e tarifave të energjisë termike për sezonin 2019/2020. Arsyet e cekura në shkresë përmbledhen në vijim:
 - NQ Gjakova, në sezonin 2019/2020, për prodhimin e energjisë termike do të bazohet në lëndën djegëse mazut, që paraqet një kosto të papërballueshme financiare për ndërmarrjen;
 - Duke marrë parasysh këtë dhe gjendjen aktuale të vështirë financiare, operimi i NQ Gjakova do të jetë në masë të madhe i varur nga subvencionet prej Buxhetit të Kosovës – për vitin kalendarik 2019 janë siguruar subvencionet ndërsa shpresohet se do të sigurohet një shumë e mjaftueshme edhe për vitin 2020.
 - Sa i përket projekteve zhvillimore, NQ Gjakova është fokusuar në projektin për ndërtimin e ngrohtores së re dhe njësisë së kogjenerimit me biomasë në vlerë prej rreth 14 milion Euro të financuar nga BE; ky projekt është në fazën finale të marrjes së lejeve përkatëse përfshirë edhe autorizimin final për ndërtim, që do të pasoj menjëher me fillimin e realizimit të punimeve ndërtimore dhe instaluese. Realizimi i këtij projekti do mundësojë që në të ardhmen të ofrohet furnizim i pandërprerë dhe kualitativ.



- Sidoqoftë deri në realizimin e tij NQ Gjakova do përpiqet të mbajë vazhdimësinë e operimit dhe të ofroj furnizim brenda mundësive të limituara financiare, ashtu që gradualisht të rikthej besimin e konsumatorëve.
2. Bordi i ZRRE-së ka mirëkuptuar faktet e paraqitura në shkresën e NQ Gjakovës, por megjithatë ka kërkuar të ndërmerret një vlerësim gjithëpërfshirës i performancës financiare dhe energjetike të NQ Gjakovës, që do të përfshijë realizimet e sezoneve të kaluara dhe planifikimet për sezonin e ardhshëm 2019/2020. Në vijim të kësaj kërkesë stafi përkatës profesional i ZRRE ka ndërmarrë një analizë të realizimeve të 3 sezoneve të kaluar dhe njëkohësisht ka kërkuar nga NQ Gjakova planifikimet për sezonin 2019/2020, me qëllim të vlerësimit real të gjendjes dhe performancës financiare dhe energjetike të NQ Gjakovës, si dhe vlerësimit të gjithë komponentëve të nevojshëm për një shqyrtim të mirëfilltë tarifor. Në këtë kuptim ZRRE ka vlerësuar realizimet dhe planifikimet e kostove operative dhe kapitale, të prodhimit dhe furnizimit të energjisë termike, si dhe të dhënat e konsumatorëve, dhe ka arritur në këto përfundime:
- Gjendja aktuale financiare dhe çmimi i lartë i lëndës djegëse – mazutit, kushtëzojnë një furnizim të kufizuar me mazut e rrjedhimisht dhe prodhim dhe furnizim të kufizuar me energji termike; duhet theksuar se blerja / furnizimi me mazut tërësisht është i varur nga subvecionet prej Buxhetit të Kosovës gjegjësisht nga ndarjet e pritshme të buxhetit të vitit 2020, i cili ende nuk është miratuar.
 - Po ashtu kostot tjera operative dhe të mirëmbajtjes reflektojnë mundësitë e limituara financiare në atë masë sa të mundësojnë një operim bazik dhe furnizim të kufizuar me energji termike.
 - Në këtë aspekt, furnizimi me energji termike është i kufizuar për një periudhë tre-mujore (muajt më të ftohtë të sezonit, dhjetor – shkurt), e gjithashtu është përgjysmuar numri të konsumatorëve gjegjësisht sipërfaqet ngrohëse të konsumatorëve.
 - Gjithashtu, gjendja e vështirë financiare pamundëson çfardo vetë-financimi të investimeve të reja në sistemin e ngrohjes qendrore të NQ Gjakovës, që do ndikonte në zvoglimin e humbjeve në rrjet dhe në stabilimentet e prodhimit të ngrohjes, që aktualisht vlerësohen mjaft të mëdha. Ndërlidhur me këtë duhet theksuar se, sa i përket projekteve zhvillimore, tërë aktiviteti është përqendruar në projektin për ndërtimin e ngrohtores së re dhe njësisë së kogjenerimit me biomasë, i financuar nga BE.
- Vlerësimet e lartëpëshkrura të komponentëve kryesorë për shqyrtim tarifor, argumentojnë se aktualisht është shumë e vështirë të bëhet çfarëdo planifikimi (parashikimi) real dhe mjaftueshëm i saktë për të ndërmarrë një shqyrtim të mirëfilltë tarifor, që do rezultonte me përcaktim korrekt të të Hyrave të lejuara dhe tarifave për sezonin 2019/2020.
3. Bordi i ZRRE ka marr parasysh arsyetimet e paraqitura në shkresën e NQ Gjakova, si dhe Vlerësimin e ZRRE-së për gjendjen dhe performacën financiare dhe energjetike të NQ Gjakovës, duke i konsideruar të drejta dhe të argumentuara.
4. Duke marr parasysh dispozitat ligjore të theksuara në hyrje dhe duke u bazuar në shqyrtimin e shkresës së NQ Gjakova dhe Vlerësimin e ZRRE-së për gjendjen dhe performacën financiare dhe energjetike të NQ Gjakovës, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Struktura e tarifave të energjisë termike për NQ Gjakova sh.a. për sezonin e ngrohjes 2019/2020 është dhënë në tabelën II.1 më poshtë.



Tabela II.1: Struktura e tarifave të energjisë termike për NQ Gjakova sh.a. – sezoni 2019/2020

TARIFAT E ENERGJISË TERMIKE TË NQ GJAKOVA - Sezoni 2019/2020			
A: TARIFAT E ENERGJISË TERMIKE ME MATJE			
Komponentët e tarifës	Njësia	Vlera	
Tarifa Mujore për Kapacitetin Termik (Komp. fikse)	[€/kW/muaj]	0.91	
Tarifa për Furnizim /Konsum të En. Term. (Komp. variabile)	[€/MWh]	58.76	
B: TARIFAT E ENERGJISË TERMIKE PA MATJE			
Komponentët e tarifës	Njësia	Konsumat. shtëpijak	Konsumat. Kom&Inst.
Tarifa mujore për Kapacitetin Termik (komponenta fikse)	[€/m ² për muaj]	0.09	0.12
Tarifa për Furnizimin /Konsumin e En. Term. (komp. variabile)	[€/m ² për muaj]	0.88	1.27

- III. NQ Gjakova sh.a. duhet ta publikoj strukturën e tarifave të energjisë termike siç është përcaktuar në tabelën II.1 të këtij Vendimi, brenda pesë (5) ditëve të punës pas shpalljes dhe publikimit të këtij vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, në së paku një prej gazetave ditore me qarkullim më të gjerë në Kosovë.
- IV. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka të drejtë, që të auditojë regjistrat e kontabilitetit dhe faturat e NQ Gjakova, për të verifikuar realizimin e të hyrave dhe kostove të realizuara në sezonin 2019/2020.
- V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të zbatohet nga NQ Gjakova nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi gjer në shqyrtimin e ardhshëm tarifor; ky Vendim publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Vendimi ju dërgohet:

- Palës; dhe
- Arkivit të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d. kryesues


Besim Bejriaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar